



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Intering&Mel Engineering&Benita" për aktivitetin: < "Ndërtimi i kanalizimit fekal, atmosferik, ujësjellësit dhe rekonstruimi i rrugës dhe trotoreve në lagjen "Sofalia" për rrugët "Shpëtim Robaj" dhe "Sabit Mushica"> dhe me numër të prokurimit: 616 -18-415-511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Intering&Mel Engineering&Benita" e datës 07.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kanalizimit fekal, atmosferik, ujësjellësit dhe rekonstruimi i rrugës dhe trotoreve në lagjen "Sofalia" për rrugët "Shpëtim Robaj" dhe "Sabit Mushica"> me Nr. 616 18 415 511 Nr. Brendshëm 616 18 12 511 kundër *Njoftimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës 04.09.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 04.09.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Intering&Mel Engineering&Benita" me datë 07.09.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal, atmosferik, ujësjellësit dhe rekonstruimi i rrugës dhe trotoreve në lagjen "Sofalia" për rrugët "Shpëtim Robaj" dhe "Sabit Mushica"> me numër të prokurimit 616 18 415 511 dhe numër të brendshëm 616 18 12 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 07.09.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1.Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se i ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike sipas paragrafit 1 të nenit 69 të LPP është plotësisht i pa qëndrueshëm për arsye se Autoriteti Kontraktues bazuar pikërisht në nenin 69 pika 4.5 ke kërkuar plotësimin e Aneksit 7,në të cilin tenderuesit duhet të paraqesin listën e paisjeve të cilat i plotësojnë kërkesat e pikës III.2.4.3 të Njoftimit për kontratë dhe pikës 9.2.3 të FDT-së dhe si dëshmi të dorëzojnë librezat e qarkullimit dhe deklaratat unike doganore,respektivisht dëshmia e kërkuar si vijon:

Deshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve ,Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit.

Pretenduesi me rastin e dorëzimit të tenderit nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë Unike doganore dhe poashtu nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë doganore për mjetet nga lista e dorëzuar me tenderin e tij,por ka paraqitur disa deklarata për mjetet që nuk janë përfshirë në listë.Nga kjo rrjedh se përpos mungesës së Deklaratave unike doganore,për mjetet nga lista pretenduesi ka paraqitur mjete të reja e që paraqet kundërshtim me sqarimet elejuara dhe të kërkuara në bazë të nenit 72 të LPP-ik dhe nenit 39.8 të RRUOPPP-së.


2.Pretendimi tjetër se nuk është njoftuar për mangësitë teknike dhe profesionale që nga hapja e tenderit i sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimet për të gjithë tenderuesit në harmoni me nenin 42 të LPP-ik dhe nenin 43 të RRUOPP-ik.

3.Poashtu lidhur me pretendimin se kinse i njëjti ka filluar përgatitjet për realizim të kontratës ia përkujtojmë pretenduesit se përgatitjet e tilla i bëjnë vetëm tenderuesit qe kanë kontraktuar punë dhe kanë aprovuar një Plan të menaxhimit me zyrtarët e autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

Bazuar në të gjitha sqarimet paraprake u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit